



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
MBLEDHJA E GJYQTARËVE

Nr. 1058 Prot.

Tiranë, më 15.10. 2019

VENDIM

“I Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”

Nr. 24, datë 15.10.2019

Në zbatim të nenit 8 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese, të ndryshuar, Mbledhja e Gjyqtarëve;

VENDOSI:

1. Miratimin nen për nen të disa ndryshimeve në rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të intresave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Natasha Mulaj



Për disa ndryshime në rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit”

Në mbështetje të nenit 8 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, Mbledhja e Gjyqtarëve;

V E N D O S I:

Në rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. “Zyrtar” është gjyqtari, këshilltarët ligjore dhe ekonomikë të Njesisë së Shërbimit Ligjor të Kolegjit, të cilët trajtohen sipas nenit 26 të ligjit nr. 9367/2005 dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit, i cili trajtohet sipas nenit 31 të ligjit nr. 9367/2005. Zyrtarët e tjerë të Kolegjit trajtohen sipas ligjit nr. 9367/2005 për identifikimin dhe regjistrimin e konflikteve të interesave, rast pas rasti”.

Neni 2

1. Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Anëtari i Kolegjit, këshilltari ligjor, këshilltari ekonomik dhe çdo zyrtar tjetër i Kolegjit mbart detyrimin për të garantuar paanësinë, duke deklaruar dhe shmangur çdo situatë konflikti interesi sipas përcaktimeve të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 9049/2003 dhe për aq sa është e mundur ligjit nr. 9367/2005.”

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Rregullorja nuk zbatohet për proceset gjyqësore, sipas rastit për juridiksion rivlerësimi apo disiplinor, brenda të cilave identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave përkatëse procedurale. Identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas kësaj rregulloreje, bëhet vetëm për ato veprime që kryhen jashtë procesit gjyqësor.

Neni 3

1. Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:
 - a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:
- “2. Kufizimet e interesave private, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367/2005, zbatohen për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 84/2016.
 - b) Pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.

Neni 4

1. Në nenin 18, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në titullin e nenit fjalët “rast për rast”, hiqen.
 - b) Pika 1, shkronja “d” shfuqizohet.

Neni 5

1. Në nenin 20 bëhen këto ndryshime:
 - a) Pika 2 shfuqizohet.
 - b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për sa u përket kufijve të zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital, për zyrtarin e Kolegjit dhe personin e lidhur me të, nuk gjejnë zbatim parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3 të ligjit nr. 9367/2005.”

Neni 6

Në nenin 22, pika 1 fjalët “në ligjin nr. 9367/2005 dhe”, hiqen.

Neni 7

Dispozitë kalimtare

Ndryshimet e kësaj rregulloreje hyjnë në fuqi menjëherë dhe kanë efekt prapaveprues që nga data e miratimit të parë të kësaj rregulloreje.